



Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (GZ e RK nr.28/2008), nenit 1 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nr.03/L-215 (GZ e RK nr.88/2010), nenit 11 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.01/2015 për Transparencë në Komuna, neni 9 të Rregullores 01 Nr. 011-2784/2009 për Transparencë në Komunën e Gjakovës, Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me dt.30.03.2018e, e miraton:

### PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË NË KOMUNËN E GJAKOVËS PËR VITIN 2018

Komuna e Gjakovës do të ndërmerë të gjitha veprimet të cilat janë në funksion të qytetarëve për sigurimin dhe avancimin e transparencës së plotë lidhur me punën dhe aktivitetet e Kuvendit të Komunës, trupave ndihmëse të Kuvendit, si dhe vendimeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës publike komunale. Këto veprime janë të parapara në këtë Plan të Veprimit për Transparencë Komunale për Vitin 2018, me qëllim të arritjes së objektivave vijuese:

**1. Rritja e Transparencës Komunale në organet e saj dhe në institucionet e administratës publike komunale. Ky objektiv do të përmbushet përmes aktiviteteve si në vijim:**

**1.1** Publikimin me kohë të të dhënave për aktivitetet e organeve të Komunës, duke përfshirë aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Mbledhjet e Komiteteve, dhe takimet tjera publike;

**1.2** Transmetimin i drejtpërdrejtë televiziv i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës;

**1.3** Publikimin e vendimeve, rregulloreve dhe dokumentacionit tjetër që miratohet nga Kuvendi i Komunës, si dhe vendimeve të Kryetarit të Komunës;

-Përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përshkruara në pikën 1 të këtij Plani është Zyra për Informim.

**2. Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile përmes proceseve gjithëpërfshirëse me partnerë, gjatë kohës së hartimit të projekt rregulloreve komunale, si dhe akteve të tjera në kompetencë të organeve komunale. Ky objektivi do të përmbushet përmes aktiviteteve si në vijim:**

2.1 Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatave joqeveritare dhe me qytetarë aktiv me synim për krijimin e urave të bashkëpunimit;

2.2 Bashkëpunimi me organizata dhe individ, për konsultime gjatë përgatitjes së projekte rregulloreve, përgatitjes së buxhetit dhe akteve në kompetencë të organeve komunale;

2.3 Krijimi i kushteve për pjesëmarrje të qytetarëve në mbledhjet e kuvendit, mbledhjet e Komiteteve apo në takimet e grupeve punuese;

2.4 Bashkëpunimi me organizatat e ndryshme të specializuara për ngritjen e vetëdijes dhe ofrimin e lehtësirave për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve, me theks të veçantë për mbrojtjen e grave, fëmijëve, personave të moshuar, personave me nevoja të veçanta etj.;

- Përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përshkruara në pikën 2 të këtij Plani është Zyra për Informim dhe zyrtarët tjerë të cilët ndërlidhen me këto procese.

**3. Shpallja publike në Ueb-faqe zyrtare të komunës dhe rrjeteve sociale të të gjitha vendimeve, rregulloreve, dokumenteve dhe aktiviteteve tjera të cilat nuk kufizohen sipas Ligjit përkatës për Qasje në Dokumente Publike. Ky objektivi do të përmbushet përmes aktiviteteve si në vijim:**

3.1 Publikimi në Ueb-faqe të vendimeve, rregulloreve dhe dokumentacionit tjetër që miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës;

3.2 Publikimi në Ueb-faqe i planit të buxhetit, planeve investuese, Kornizës Afatmesme të Buxhetit, dhe raportit përmbledhës të buxhetit të Komunës për vitin e kaluar fiskal;

3.3 Publikimi në Ueb-faqe i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm mbi buxhetin e Komunës për vitin e kaluar fiskal;

3.4 Publikimi në Ueb-faqe dhe rrjete sociale i njoftimeve të komunës si: njoftimet për ngjarje të ndryshme, njoftimet për konkurse, njoftime për debate publike, thirrjet për projekt propozime, thirrjet për subvencionim;



### 3.5 Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve të ndryshme promovuese.

- Përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përshkruara në pikën 3 të këtij Plani është Zyra për Informim, Zyra për Teknologji Informativë, dhe Qendra për Informim me Qytetarët.

**4. Ofrimi i shërbimeve në mënyrë elektronike përmes përdorimit të softuerëve dhe pajisjeve të Teknologjisë Informativë e qëllim të ofrimit të shërbimeve të shpejta dhe transparente për qytetarët. Ky objektivi do të përmbushet përmes aktiviteteve si në vijim:**

4.1 Ofrimi i shërbimeve online përmes e-shërbimeve si: E-Prokurimi, E-Punësimi, E-Administrata, E-Certifikata dhe E-Tatimi në Pronë;

4.2 Promovimi i përdorimit të platformave digjitale për ofrimin e shërbimeve komunale;

4.3 Përdorimi i Shtyllave Multifunksionale (Gjakova Smart City) me qëllim të informimit dhe komunikimit me qytetarët.

4.5 Funkcionalizimi i E-kioskave për ofrimin e certifikatave të gjendjes civile;

- Përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përshkruara në pikën 4 të këtij Plani është Zyra për Teknologji Informativë dhe Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative.

**5. Bashkëpunim i plotë me Organizatat monitoruese të punës dhe aktiviteteve komunale, duke ju ofruar atyre të gjitha materialet dhe dokumentacionet e kërkuara.**

**6. Krijimi i kushteve dhe mundësive për qytetarët dhe organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare, që të kenë qasje në të gjitha dokumentet zyrtare, bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Ky objektivi do të përmbushet përmes aktiviteteve si në vijim:**

6.1 Procesimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare dhe kthimi i përgjigjes (aprovim/refuzim) brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

- Përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përshkruara në pikën 6 të këtij Plani është Zyra për Informim – Zyrtari për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës për Vitin 2018 do të realizohet nga nëpunësit civil komunal dhe këshilltarët e ndryshëm të cilët do të angazhohen për ndihmë, të cilët mund të kompensohen nga mjetet e buxhetit komunal apo nga donacionet e ndryshme, ndërsa ky Plan mund të ndryshohet apo plotësohet sipas rrethanave dhe kërkesave të parashtruara.

01 nr. \_\_\_\_\_ 2018

Dt: \_\_\_\_\_

Gjakovë

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

\_\_\_\_\_  
**z. Anton Shala**